

Qyteti im

falas



Për herë të parë në Shqipëri,
Panairi i Fundvitit
YEP – Inkurajimi i sipërmarrësve të rinj
Në qytet si gjithë të tjerët



KORÇA KU
DUA TE JETOJ

Kalendari festiv i panairit të fundvitit

E enjte, 4 Dhjetor
Serenata korçare

E premte, 5 Dhjetor
Ekspozita e Koleksionistëve

E premte, 12 Dhjetor
“Figurat e Shquara të Sportit”, dokumentar nga Ylli Pepo dhe
Ahmet Shqarri

E diel, 14 Dhjetor
Kori i Janicasë

17 dhe 24 Dhjetor
Teatri i Kukullave

20-27 Dhjetor
”Të jesh krenar për qytetin tënd”
Ekspozita e revistës ”Qyteti im”

E diel, 21 Dhjetor
Kamela Islami

E martë, 23 Dhjetor
Ekspozita e Krishtlindjeve
Koncert me Karolat e Krishtlindjeve
Shkolla Tefta Tashko Koço

E enjte, 25 Dhjetor
Babagyshi në Panairin e Fundvitt

E enjte, 25 Dhjetor
Koncert i Korit ”Pax Dei”

26, 27, 28 Dhjetor
Variate e Fundvittit me humor, këngë dhe surpriza

20 -30 Dhjetor
Konkursi Mbarëkombëtar i Arteve Figurative ”V. Mio”

E diel, 28 Dhjetor
Artistët e vegjël ju urojnë festat

E diel, 28 Dhjetor
Olsa Papandili & The singles

E mërkurë, 31 Dhjetor
Ekspozita e fëmijëve “Cicërima mbi telajo”

Çdo fundjavë të Dhjetorit
“Babagyshi tregon përralla”



Për herë të p



Dhurata, lodra, ëmbëlsira, pije tradicionale, muzikë, argëtim, surpriza për fëmijët, të gjitha në Panairin e Fundvittit, në Korçë, në qendër të qytetit nga data 4-31 Dhjetor.

Dhjetori në Korçë, kësaj here, do të jetë shumë herë më i bukur!

Qyteti i dëborës, që lidhet me festat e fundvittit më tepër se çdo qytet tjetër në Shqipëri, kësaj here do të jetë shumë herë më i veçantë, më i bukur, më i zhurshëm, më festiv se kurrë më parë.



arë në Shqipëri, **Panairi i fundvitit**



Pas festave të bujshme të këtij viti, si karnavalet, festa e birrës, festa e lakrorit, java e muzikës, java e kinemasë, për herë të parë në Shqipëri, Korça, qyteti i festave, kulmon me Panairin e Fundvitit.

Çdo ditë, nga data 4 – 31 Dhjetor, në qendër të qytetit, në sheshin para Katedrales, qytetarët korçarë dhe jo vetëm, do të bëhen pjesë e Panairit të madh të Fundvitit.

Nuk do të mungojë asgjë, shtëpitë e drurit, elementët dekorativë, lodrat, ëmbëlsirat, pijet tradicionale, mollët e pjekura, gështenjat, babagjyshi me karrocë, muzikë në shesh, show e shumë të tjera.

Një kalendar i posaçëm aktivitetesh enkas për dhjetorin, ku

nuk do të mungojnë emra të njohur të muzikës si Zhulieta Sheremeni, Kamela Islami, Olsa Papandili, The Singles etj, do të shoqërojë vazhdimisht panairin. Ekspozitat e hapura, performancat muzikore të të rinjve, parada e babagjyshit, prania e Korit “Pax Day” ditën e Krishtlindjeve, teatri i kukullave në shesh që do t'i bashkangjiten panairit, do ta bëjnë Korçën, qytetin më dinamik e të parezistueshëm për t'u vizituar këtë fundviti.

Internet falas në 3 shkolla të mesme



Tre shkolla të mesme në qytet do të përdorin internetin falas të ofruar nga Bashkia e Korçës. Përfitues janë Shkollat e Mesme të Përgjithshme "Themistokli Gërmenji" dhe "Raqi Qirinxhi" si dhe Shkolla e Mesme Ekonomike "Isuf Gjata".

Teknologjitë e reja të informacionit, janë pjesë e vizionit të Bashkisë për ta bërë Korçën një qytet model, i cili nuk mund të jetë i tillë nëq nuk përqafohen teknologjitë e reja. Iniciativa si kjo, janë pjesë e planit të veprimit të Bashkisë Korçë, për ta bërë qytetin tonë, qytetin më të informatizuar në Shqipëri.

Sigurisht që kjo kërkon bashkëpunim mes institucioneve të ndryshme në qytet, si dhe vullnet nga të rinjtë dhe dëshirë për ta përqaftuar internetin e kompjuterin, si një mjet të të ardhmes, një domosdoshmëri për të qenë kompetitivë për t'u integruar në botën moderne. Interneti falas për të rinjtë e shkollave të qytetit, vjen pas disa projekteve të tjera të zbatuara nga Bashkia në mbështetje të të rinjve. Kështu, në muajin shtator, me rastin e fillimit të vitit të ri akademik, ajo ka dhuruar 25 kompjutera për maturantet e dalluar. Numri i përfituesve nga këto projekte do të rritet nga viti në vit, ashtu siç dhe do të zgjerohet edhe shërbimi i internetit falas në bibliotekën e qytetit, e cila e ofron sot këtë shërbim nëpërmjet 50 kompjuterave.





Bashkia PRO BIZNES

Dëshiron të ndërtosh
të ardhmen **tënde?**

Je i ri dhe kërkon **mbështetje?**

Ke **ide**, por je konfuz?

Guxon të fillosh
një biznes?

BËHU PJESË E YEP

(Young Entrepreneur Project)

"Inkurajimi i sipërmarrësve të rinj"



Incentiva Fiskale për Biznese të Reja

10 bizneset e reja që do të hapen në kuadrin e projektit YEP
"Inkurajimi i Sipërmarrësve të Rinj"

do të përfitojnë:

- Grant 130 000 Lekë
- Tarifë regjistrimi 0
- Ulje 30% në taksat dhe tarifat vendore gjatë vitit të parë të aktivitetit

Guxon të fillosh një

biznes?



Të tjera Incentiva Fiskale për Biznesin

Bashkia Korçë stimulon hapjen e bizneseve të reja në qytet duke ofruar

Tarifë regjistrimi 0 për kategoritë e mëposhtme:

- Hapje aktivitetesh që kanë lidhje me teknologjitë e informacionit (salla interneti, tregëtim/riparim kompjuterash etj)
- Hapje aktivitetesh artizanati (gurëgdhendës, gurëpunues, poçeri etj)
- Hapje aktivitetesh si çerdhe, kopshte, librari, terrene sportive dhe kënde lojrash për fëmijë

CAAP
Common Actions Against Poverty

MUND TË REGJISTROHESH DERI NË DATË 5 DHJETOR 2008
TEK ZYRA E INFORMACIONIT PRANË BASHKISË KORÇË
Tel. 082 2 43353 082 2 43382
email: bashkiko@albmail.com www.bashkiakorce.gov.al



www.bashkiakorce.gov.al

Kongresi i Manastirit Histori dhe vlera

100 vjet më parë, Kongresi i Manastirit vendosi njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Në këtë mënyrë kontributi i patriotëve më të shquar shqiptarë Gjergj Fishta, Mit'hat frashëri, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, në mes të të cilëve mjaft korçarë, si Sotir Peci, Mihal Grameno, Gligor Cilka, Sami Pojani, Thoma Avrami etj, ishte i pashëmbullt, me një vendim i cili shënoi një çast historik: Njësimin e alfabetit shqip me gërma latine, të cilat i përdorim edhe sot pas plot një shekulli .Ky ishte finalizimi i përpjekjeve të patriotëve shqiptarë nga mbarë trevat e Shqipërisë, duke zgjidhur një problem të mprehtë sa gjuhësor, aq edhe kombëtar e politik. Kongresi i Manastirit dha një mesazh shumë të rëndësishëm, se shqiptarët kudo që jetojnë, përbëjnë një komb.

Korça, i pari qytet ku filluan të mësohen shkronjat

“Ajo çka është bërë le të na shërbejë si model duke na inspiruar që ne të bëjmë më shumë e më mirë. Ne sot po përpiqemi dhe jemi në rrugë të mbarë që Korçën e Mësonjëtores së Parë Shqipe ta kthejmë në një qytet universitar duke bërë që ky qytet të vazhdojë të ruajë vendin e një qëndre të rëndësishme arsimore në Shqipëri”

Niko Peleshi

Në nderim të Kongresit të Manastirit, mbajtur 100 vjet më parë, në 14-22 nëntor të vitit 1908, dhe në nderim të shkronjave dhe të gjuhës shqipe, Universiteti “Fan.S.Noli” në Korçë dhe Bashkia e qytetit, në bashkëpunim me Akademienë e Shkencave dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale, zhvilluan një sërë veprimtarish. Ato filluan në kodrat e qytetit me një manifestim të nxënësve të shkollave 9-vjeçare të qytetit në përkujtim të Mitingut të Shkronjave, të mbajtur nga patriotët shqiptarë 98 vjet më parë, ku Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Teki Biçoku, zbuluan obeliskun në përkujtim të kësaj ngjarje. Veprimtaritë në përvjetorin e kësaj ngjarje, kulmuan me Konferencën Shkencore Mbarëkombëtare me temën: “Nga Evetarët e Naum Veqilharxhit tek Kongresi i Manastirit”, të cilën e drejtoi Rektori i Universitetit “Fan.S.Noli” Gjergji Mero. Krahas kumtesave të mbajtura nga profesorë, akademikë e studiues nga mbarë trevat shqiptare, konferencën e përshëndeti edhe Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi.



“Emblema e Artë e Qytetit” për patriotët që përfaqësuan Korçën në Kongresin e Manastirit

Me rastin e 100 -vjetorit të Kongresit të Manastirit, Bashkia e Korçës, u dha Titullin “Emblema e Artë e Qytetit”, katër personaliteteve korçare, Gligor Cilka, Sami Pojani, Thoma Avrami, Mihal Grameno, të cilët ishin disa nga përfaqësuesit e qytetit tonë në Kongresin e Manastirit, me motivacionin:

“Për veprimtari të shquar në çështjen e njësimit të alfabetit të gjuhës shqipe dhe të mësimit të saj në shkolla dhe si delegat i Korçës në Kongresin e Manastirit”




Bashkia i rikthen qytetit Obeliskun e Mitingut të Shkronjave

Kjo fotografi, e cila mban datën 14 nëntor 2008, në ditën e 100 vjetorit të Kongresit të Manastirit, në po atë kodër, ku 98 vjet më parë u mbledh Mitingu i Shkronjave, do të jetë padyshim historike.

Bashkia e Korçës, nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë Niko Peleshi, i dhuroi qytetit Obeliskun e Mitingut të Shkronjave, simbolin e përpjekjeve të atdhetarëve për gjuhën shqipe.





Rruga “Kongresi i Përmetit” si Bulevard “Republika”

Bashkia e qytetit do të këmbëngulë që avilitë ekzistuese me mur tek Rruga “Kongresi i Përmetit”, të zëvendësohen me kangjellat, të cilat janë një karakteristikë e spikatur e qytetit të Korçës. Këtë iniciativë e bëri të ditur Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi gjatë inspektimit të punimeve të kësaj rruge, e cila në sajë të investimit të Bashkisë, nga një rrugicë dytësore e kalldrëmtë, do të kthehet në një rrugë kryesore, duke u asfaltuar e sistemuar me të gjithë parametrat e një rruge moderne. Kjo rrugë, paralel me Bul. “Republika” shtrihet në pjesën historike të qytetit, ndaj Kryebashkiaku Peleshi kërkon mirëkuptimin e banorëve të kësaj rruge në mënyrë që ata të mbështesin iniciativën e tij për rrethimin me kangjella, pasi këto banesa së bashku me ato të Bul. “Republika”, do të krijojnë një ansambël mjaft të bukur dhe karakteristik për qytetin tonë. Asfaltimi i kësaj rruge është një hap i rëndësishëm edhe për faktin se ajo do të pranojë një fluks më të madh të lëvizjes së automjeteve duke çliruar akset e tjera të qytetit dhe njëkohësisht, do të mbrojë rrugicat e kalldrëmta nga dëmtimi.

Kompletohet Blloku i Shën Mërisë

Në fund të nëntorit të këtij viti, të gjitha rrugicat mes pallateve si dhe rrugicat ndërmjet Lulishtes “Shën Mëria” u asfaltuan dhe u sistemuan me bordura e trotuare, duke e përmirësuar ndjeshëm pamjen e këtij kompleksi, i cili është mjaft i frekuentuar nga të gjitha moshat. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike bëri një punë voluminoze për heqjen e mbetjeve inerte, mbushjen me dhe, nivelimin dhe sistemimin e një sipërfaqeje prej 1930 m².

Në të gjithë lulishten përfundoi mbjellja e barit, duke përfshirë këtu edhe minilulishtet dhe brezat e gjelbër që u krijuan pas asfaltimit dhe sistemimit të këtij blloku. Në të njëjtën kohë, u bë dhe plotësimi me bimësinë e lartë dhe shkurre dekorative të llojeve të ndryshme. Po punohet për kompletimin e saj me stola.

Drurë dekorativë u mbollën edhe përgjatë Rrugës “1 Maji”, duke e gjelbëruar edhe këtë rrugë ashtu si rrugët e tjera në qytet.






Përkujtohen festat e 28 e 29 Nëntorit

28 e 29 Nëntori, dita e Shpalljes së Pavarësisë dhe dita e Çlirimit të Atdheut, mbeten dy ngjarjet më të rëndësishme historike për shqiptarët kudo që ndodhen. Këto dy data janë kryefesta e shqiptarëve, ndaj si çdo vit, edhe sivjet Korça ishte në festë. Ajo përkujtoi 96 –vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë dhe 64 –vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Mëngjesin e 28 Nëntorit, Korça u zgjua me tingujt e marsheve të bandës së qytetit, e cila nisi parakalimin e saj solemn në qendër të tij. Më tej, kurora e buqeta me lule u vendosën para Luftëtarit Kombëtar për të vazhduar me celebrimin e flamurit tek Katedralja. Festimet vijuan në Teatrin “Andon Z.Çajupi” me koncertin festiv, në të cilën u çel edhe ekspozita fotografike e figurave më të shquara të patriotëve shqiptarë. Në datën 29 Nëntor, me rastin e 64 -vjetorit të Çlirimit të Atdheut, në Varrezat e Deshmorëve të Atdheut u zhvilluan homazhe.



Supplement



Pirro Thomo tek “Qyteti im”

Pirro Thomo tek “Qyteti im”

Z. Pirro Thomo është diplomuar në vitin 1962 në Degën e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit të Tiranës. Në vitin 1981 ka marrë Gradën «Kandidat i Skenave». Ndërkohë është nderuar me titullin «Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor» (1983), gradën «Doktor i Skenave» (1988), titullin «Drejtues Kërkimesh» (Profesor), për veprimtarinë shkencore në fushën e studimit të Historisë së Arkitekturës dhe të restaurimit (1994).

Në vitet 1975-80 ka punuar në Korçë si përgjegjës i Ateliesë së Monumenteve, një nga periudhat më aktive të karrierës profesionale. Që prej vitit 1991 jeton dhe punon në Selanik, Greqi, ku vazhdon punën e studiuesit dhe restauratorit në institucione private e shtetërore. Pavarësisht qëndrimit atje, profesor Pirro Thomo vazhdon bashkëpunimin me institucionet e vendit për restaurimin e monumenteve të kulturës. Vitet e fundit u angazhua në ristudimin e Qendrës Historike të Korçës dhe projektin e restaurimit dhe të rivalizimit të pazarit të qytetit.

Qyteti im - Z. Thomo, cilat janë urat që ju lidhin me qytetin e Korçës?

P. Thomo - Urat që më lidhin me qytetin e Korçës janë të shumta, duke filluar që nga origjina e deri tek çdo marrëdhënie njerëzore të krijuar, që nga fëmijëria e deri në ditët e sotme. Kam banuar tri herë në Korçë: në kohën e fëmijërisë, kur im atë u transferua në Korçë, në kohën e adoleshencës, kur shkoja për pushime të gjyshja dhe në kohën e pjekurisë, kur u qarkullova në Korçë në vitet 1975-80. Nga periudha e parë më ka mbetur e pashlyeshme kujdesi dhe dashuria e bashkëmoshatarëve, Andreas, Nikos, Pandit, Violetës etj., për të na integruar në shoqërinë e tyre, kujtimi për mësuesen Stathën, për “xhaxhi” Kollën Karabuzi, të zotit të shtëpisë ku banonim, për familjet Cikulli, Pipa, Spaho e shumë të tjera. Me shumë nga shokët e asaj kohe mbaj ende, edhe pas kaq e kaq vitesh, marrëdhënie shumë miqësore.

Nga periudha e dytë më janë fiksuar pamjet e Bulevardit Republika, kur më merrte xhaxhai për të shëtitur me shoqërinë e tij. Duke mos mundur të merrja pjesë në bisedat e tyre, vrojtoja dhe admiroja shtëpitë, oborret e vogla përpara tyre të mbajtura me kaq kujdes e dashuri dhe të mbushura me lule nga më të bukurat, rrethimet me kangjella dhe dekoracionet e tyre. Dhe, papritur, vrojtimi ndërpritej dhe vështrimi qetësohej, kur në intervale të caktuara hapje peizazhi drejt kodrave të qytetit dhe bënte të mos ndjeje lodhja, sado xhiro të bëje në këtë shtëtorie. Gjithashtu shumë përshtypje më bënte edhe pazarit, kur shkonim për të psonisur, për gjallërinë e tij, për larminë e aktiviteteteve, për mallin që tregtohej. Ishte gëzimi i jetës. Ku ta dija se pas shumë vitesh do ta studioja gur për gur dhe, akoma pas shumë e shumë vitesh të tjera, më se 30 vjet, materialet e studimit që kisha grumbulluar dhe i ruaja me kujdes në një kënd edhe në emigracion, do të shërbenin për studime të mëtejshme.

Gjatë periudhës së tretë kujtimet dhe mbresat e kaluara jo vetëm nuk ishin zbehur, por ato morën një gjallërim të fuqishëm. Atëherë fillova të studioj historinë e qytetit, jetën ekonomike, shoqërore e kulturore të tij, që më dhanë mundësinë të shpjegoja dhe të interpretoja karakterin dhe vlerat urbanistike e arkitektonike të Korçës, që e reshtonte atë ndër qytetet më të zhvilluara jo vetëm në Shqipëri, por dhe vendet e Ballkanit. Këto vlera do të përcaktonin kriteret e restaurimit dhe do të rrisnin përgjegjësinë për ndërhyrjet restauruese, të cilat i realizuan me sukses mjeshtrat duarartë korçarë, Dhosi Çollaku, Tasi Qafëzezi, Berti Plumbi, grupi i polenakëve, Taqkë Koti e të tjerë.

Ura të reja, siç thoni ju, u hodhën në këtë periudhë. Ishin miqtë e mij të rinj Avni Bilbili, Jorgji Profiri, Riza Hysa, Gjergji Çikopani e shumë të tjerë. M'u afruan edhe një grup, atëhere studentë, që u bënë më vonë arkitektë të talentuar dhe bashkëpunëtorë të mij si Aleko Papakozmai, Kliti Kallamata, Naumaq Mara, si dhe piktori i talentuar Dhimitër Çika etj.

Qyteti im - Çfarë efekti ka ndalimi i ndërtimeve bashkëkohore në zonën historike?

P. Thomo - Qendra Historike e Korçës pasqyron historinë e zhvillimit të qytetit.

Ansambli në lagjen nr.3 është pjesa më e vjetër e ruajtur e qytetit, e cila krijon atmosferën e jetës të një periudhe të hershme të zhvillimit të qytetit. Ansamblet në lagjen nr.12 dhe në të dy anët e shëtitores “Republika” dokumentojnë zgjerimin e qytetit në troje të reja, ku për herë të parë në Shqipëri dhe ndër të parat në Ballkan u zbatua një sistem urbanistik i planifikuar, i përparuar dhe i shoqëruar me arritje të shënuara arkitektonike dhe dekorative. Kushtëzimi i ndërtimeve bashkëkohore në zonat historike ka për qëllim të ruajë atë karakteristikë të Korçës, që e bën të dallojë nga qytetet e tjera dhe të ruajë atë trashëgimi si një dëshmi e një të kaluarë të respektuar. Ndërtimet e reja, të ngritura këto vitet e fundit, shpesh nuk kanë lidhje me ndërtimet ekzistuese dhe si të tilla çënojnë karakterin urbanistik dhe arkitektonik të Qendrës Historike. Një reflektim ndaj gjendjes së krijuar është hartimi i një projekti rigjenerimi, që do të kontrollojë ndërtimet e reja në zonat historike, në mënyrë që ato të harmonizohen me ndërtimet ekzistuese dhe të nxjerrin në pah vlerat e tyre.

Qyteti im - Si e sheh arkitekti Thomo zhvillimin e sotëm urban të qytetit të Korçës?

P. Thomo - Zhvillimin e sotëm urban të qytetit të Korçës e shoh me optimizëm. Korça është ndër ato qytete apo qendra, të cilat ende nuk janë prekur shumë nga ai bum ndërtimesh, që shpesh kanë krijuar një konfuzion urbanistik, duke mos respektuar as kriteret më elementare të organizimit të një kuartalli, lagjeje apo qyteti. Për më tepër Korça ka shumë hapësira të reja ku mund të ndërtohet.

Qyteti im - Çfarë duhet të ketë Korça ndryshe dhe cilat janë ato pjesë që nevojiten ndërhyrje transformuese për t'i dhënë një tjetër frymëmarrje më bashkëkohore Korçës?

P. Thomo - Së pari, të tëra shtëpitë e Bulevardit Republikës, por edhe të zonave të tjera, duhet të restaurohen, në mënyrë që të rimarrë shëtitorja aq e dëgjuar vlerat piktoreske, të cilat tashmë i janë zbehur. Së dyti, zona industriale të rigjenerohet sa më parë, në mënyrë që Korça të ketë një hyrje më dinjitoze.

Arritjet e së kaluarës, si organizimi i studiuar i lagjeve, respektimi i ansambleve të zanafilës, pa ndërhyrë në to, shfrytëzimi i trojeve të lira, si dhe cilësia e lartë e ndërtimit, janë disa nga mësimet që mund të nxirren nga kjo e kaluar. Ndërsa ruajtja e zonave historike, siç vërehet në shumë qytete të botës, duhet konsideruar si detyrim, sepse dëshmon që kulturën e të ndërtuarit dhe të jetuarit Korça e ka shumë të herëshme. Bashkëjetesa dhe harmonizimi i së vjetrës me të renë do të mund të krijonin një tjetër tipar të veçantë për qytetin.

Po të bëhen të tëra këto, Korça, si gjithmonë, do të jetë ndryshe nga gjithë qytetet e tjera, siç ka qenë historikisht.

Qyteti im - Si e vlerësoni ndërtimin e Zonës Këmbësore përgjatë Bul. Shën Gjergjit


P. Thomo - Ndërtimin e Zonës Këmbësore përgjatë Bulevardit të Shën Gjergjit e vlerësoj shumë pozitivisht dhe kam shumë dëshirë të realizohet. Zona Këmbësore e projektuar, e cila në të ardhmen mund të shtrihet dhe në zona të tjera, jo vetëm që do të ripërtërijë traditën korçare të shëtitjes, por do të krijojë për qytetarin një mjedis njerëzor, çlodhës, takimesh dhe afrimi me njëri-tjetrin.

Qyteti im - Jo vetëm si arkitekt por sidomos si korçar në fund dua t'ju pyes se pse duhet të vizitosh Korçën?

P. Thomo - Korça duhet vizituar për shumë arsye. Për të admiruar vlerat historike e kulturore të qytetit, për t'u njohur me qytetarët korçarë punëtorë, krijues e me kulturë qytetare solide, për t'i ndjerë muzikën dhe këngët karakteristike, për të shëtitur në mjedisin rrethues të qytetit, prej nga hapen pamje, që me aq poezi i ka fiksuar në tablotë e tij Vangjush Mioja, për të shijuar, pse jo mbas këtyre shëtitjeve, Birra Korçën me famë me kërnackat tradicionale, për t'u ngopur me ajrin e freskët dhe klimën e shëndetshme. Dhe më tej do t'ia vlenë një ekskursion në qendrat turistike e kulturore të rrethinës: në Dardhë, Voskopojë, Mborje, në liqenin e Prespës, në malin e Moravës etj.

DHIMITËR MBORJA EMANOIL (1884-1945)

Lindur në Mborje. Anëtar i shoqërisë “Dituria” të Korçës më 1908. Kryetar i shoqërisë patriotike të shqiptarëve të Bukureshtit. Boton e shpërndan programin e komitetit të fshehtë “Për lirinë e Shqipërisë”. Më 5 nëntor 1912 merr pjesë në mbledhjen e Bukureshtit. Më 28 nëntorit 1912, firmon aktin e pavarësisë me siglën “Dh Emanuel” në emër të kolonisë së Bukureshtit. Në shkurt 1915 zgjidhet këshilltar pranë shoqërisë së “Komunitetit Ortodoks Shqiptar të Bukureshtit”, e cila punonte për të mbajtur një shkollë në gjuhën shqipe. Rreth vitit 1920, lëshoi darovisht godinën e shtëpisë së tij në Korçë si ambient mësimor për Liceun Kombëtar. Më 1924 mbështet qeverinë e Nolit. Largohet në Rumani për t’u rikthyer në atdhe vite më vonë. Vdiq në Bukuresht.



Dhimitër Emanoil Mborja
**Dhimitër
 Emanoil Mborja**



Thanas V. Floqi
**Thanas
 Floqi**

THANAS FLOQI (1884-1945)

Lindur në Korçë. Përfundoi studimet universitare në Athinë, në fakultetin e drejtësisë. Në vitin 1905 vendoset në qytetin Jamestoën. Merr pjesë në themelimin e shoqërisë “Mali i Mëmdehut” më 1906. Shërben si kronikan i gazetës “Kombi” të Sotir Pecit. Kthehet në atdhe në korrik 1908, qëndron në Vlorë. Themelon mandolinatën “Labëria” dhe qëndron dirigjent i saj. Në Kongresin historik të Vlorës, mori pjesë si delegat i Korçës dhe më 28 nëntor 1912 firmoi vendimin e pavarësisë me siglën “Thanas V. Floqi”. Caktohet gjyqtar në Elbasan. Ka përkthyer me mjeshtëri në gjuhën shqipe “Tre muskëtjerët” e A. Dumasë, “Jeta ushtarake” të E.de Amiçis, romanin “Ditët e prapme të Pompeit” të Lyttonit; romanion “Arsen Lupeni kundra Sherlock Holmesit” të M. Leblanc; ka botuar një fjalor italisht – shqip më 1939. Më 1910 botoi një gramatikë të gjuhës shqipe. Vdiq në Elbasan.

DHIMITËR BERATI (1888-1970)

Lindur në Korçë. Përfundoi në Rumani fakultetin e shkencave politike dhe atë juridik. Pas vitit 1905 kthehet në Korçë, ku punon si mësues në shkollën e parë shqipe. Anëtar i klubit patriotik “Dituria” që në themelimin e tij. Më 13 dhjetor 1909 merr pjesë në shfaqjen e dramës “Besa” si sufler. Po këtë vit merr pjesë në Kongresi i Elbasanit, kurse më 1910 në Kongresi i dytë i Manastirit. Ka firmuar aktin historik të shpalljes së pavarësisë, me siglën “D. Beratti”, si delegat i kolonisë së Bukureshtit. “Drejtor i përgjithshëm” në organin e qeverisë së Vlorës “Përlindja e Shqipëniës” dhe u zg-

jodh anëtar i pleqësisë. Më 1913 sekretar i delegacionit shqiptar që udhëton në Londër, Paris, Romë, etj. Delegat i shqiptarëve të Bukureshtit në Konferencën e Paqes më 1919. Mbretëria rumune më 1932 e dekoroi me medaljen “Grand Officer De La Courron Roumania”. Vdiq në Romë.

Në numrin e ardhshëm do të lexoni biografitë e tre korçarëve të tjerë, firmëtarë të aktit të pavarësisë



Burime:

Librat:

“Fjalori enciklopedik shqiptar”, Tiranë, 1985
 “Korça, në faqet e historisë”, Emin Selenica
 “Një faqe historike”, Nikollaq Zoi, Korçë, 2000
 “Korça - urbanistika, arkitektura”, Pirro Thomo
 “Mbi themelimin e Korçës” (broshurë) Arben Gjata
 “Shqipëria më 1928”, Teki Selenica, Tiranë, 1928
 “Shqipëria e ilustruar më 1928”, Teki Selenica, Tiranë, 1928
 “Korça dhe fshatrat përçark”, Nuçi Naçi, Sofje, 1901
 “Korça dhe katundet e çarkut” (ribotim i plotësuar), Nuçi Naçi, Korçë, 1923
 “Historia e Shqipërisë” vëll. II, Tiranë 1965
 “Themistokli Gërmenji”, Pirro Tako, Tiranë, 1988

Gazetat:

(Koleksion pranë Bibliotekës “Thimi Mitko” dhe Bibliotekës Kombëtare Tiranë)
 “Korça” drejtuar nga Sami Pojani e Lutfi Zavalani, Korçë, 1908-1910
 “Lidhja othodokse”, drejtuar nga Mihal Grameno, Korçë, 1909
 “Koha” drejtuar nga Mihal, Mina e Koço Grameno, Korçë, 1911-1926
 “E drejta”, drejtuar nga Leonidha Naçi, Korçë, 1924
 “Gazeta e Korçës”, drejtuar nga Zhan Gorguzi. Koleksion i viteve 1930-1935

Përgatiti: Niko Kotherja

Banesa e Vëllazërisë Frashëri

Banesa “Vëllazëria Frashëri” është e Periudhës së Rilindjes, e ndërtuar në vitin 1870 dhe mban karakteristikat e stilit të arkitekturës të kësaj periudhe. Ajo është shpallur Monument Kulture në vitin 1973. Adresa e sotme e banesës: Rruga “Niko Dodona” në Lagjen 12 të qytetit.

Ndërtesa është dykatëshe, me qilare të larta gati sa një kat, të cilat kanë hyrje të veçantë nga jashtë dhe lidhje të brendshme dhe të përshtatshme për banim. Katët e sipërme janë mjaft të larta, gati 3 m. Sallonet qendrore komunikojnë me katër dhoma në çdo kat, ndërsa në katin e sipërm shkëputet e del tej planit të mureve, qoshku i ndërtuar me strukturë çatmaje. Karakteristikë e kësaj banese është ballkoni qëndror ku pritëshin mysafirët. Në ballinë është më i formuar theksimi qëndror. Bie në sy portiku me dy kolona druri, që mban qoshkun e dalë në katin e dytë. Shtëpia është e gjitha me mur guri. Ndërsa kati i parë ka fugaturë të gurëve, kati i sipërm është i suvatuar. Në ndarjen e kateve kalon një kornizë druri, ndërkohë që edhe dyert dhe dritaret janë prej druri. Godina është e thjeshtë në dekoracion. Edhe në pjesën e brendshme të banesës, druri gjen një përdorim të gjerë, në shkallët, dysheme dhe tavanët të cilët janë të veshur pjesërisht me dërrasë.


Edhe sot, pas dy restaurimeve në vitet 1970 dhe 2006-2007 ajo i ruan karakteristikat e saj si në pjesën e brendshme edhe atë të jashtme, ndërkohë dritaret e katit të dytë janë zëvendësuar me të reja. Sipërfaqja e kësaj godine është 205 m², mbase një ndër më të mëdhatë e asaj kohe.



Familja Frashëri rrjedh nga një familje e mesme qytetare korçare me tradita të spikatura arsimdashëse dhe patriotike. Këtë e faktin edhe çelja për herë të parë në të, në vitin 1891 e Shkollës së Parë të Vashave, e cila e zhvilloi aktivitetin e saj për mëse një vit. Andon Frashëri, një prej vëllezërve të familjes ishte sekretari personal i Fan Nolit në qeverinë e tij, në vitin 1924. Aktualisht godina është e banueshme, administrohet nga trashëgimtarët e familjes dhe është e vizitueshme.



**Burimi i informacionit: Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës, Korçë
Nedai Thëllimi - studiues, historian**



Në qytet si gjithë të tjerët

50 fëmijë të shkollave periferike të qytetit, një pjesë e të cilëve vijnë nga komunitetet në nevojë, vizituan për herë të parë institucionet kulturore më të rëndësishme të qytetit. Me sloganin “Në qytet si gjithë të tjerët”, kjo vizitë ishte dhurata që u bëri Bashkia e qytetit këtyre fëmijëve në Ditën Botërore të të Drejtave të Fëmijëve. Të shoqëruar nga punonjësit e Zyrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Bashki, fëmijët u njohën nga afër me Bibliotekën e qytetit, Qendrën Kulturore, Muzeun e Shkollës së Parë Shqipe, Muzeun e Artit Mesjetar dhe Muzeun Oriental “Bratko” duke marrë me vete mbresa e emocione.

Po në këtë ditë, Kryetari Bashkisë Nko Peleshi vizitoi fëmijët e kopshtit rom “Lulet e vogla”. Gjatë vizitës, ai dhuroi për secilin një paketë me mjete mësimore dhe më pas dëgjoji prej tyre, të drejtat që kanë fëmijët për t’u shkolluar, argëtuar etj. Më tej aktivitetet e kësaj dite vazhduan me koncertin e nxënësve të Shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”.



Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Seksioni i Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve është një strukturë e re në përbërje të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Korçë. Punonjësi i Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve është përgjegjës dhe përfaqëon Bashkinë në çështjet e të drejtave të fëmijëve.

Bashkia e qytetit, nëpërmjet kësaj zyre, po implementon projektin “Një përqasje ndërsektoriale në mbrojtje të fëmijëve”. Kjo iniciativë përfshin dhe angazhon të gjitha strukturat lokale në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në nevojë.





Kori Lira në Festivalin e Këngës Qytetare në Tetovë

Më 22 nëntor, Kori Lira e përfaqësoi këngën qytetare korçare, në Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës Qytetare në Tetovë të Maqedonisë.

Së bashku me trupën e qytetit të Pogradecit, ato përfaqësuan Shqipërinë në edicionin e dytë të këtij festivali, ku morën pjesë njëkohësisht, trupat shqiptare nga Maqedonia e Kosova. Ky ishte një organizim i Teatrit të Tetovës, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës Maqedonase, në të cilën Kori Lira u vlerësua me «Çmimin e Mirënjohjes».



“Velloja e bardhë”, monodramë në Teatrin “Çajupi”

“Velloja e bardhë” titullohet monodrama e cila u vu në skenën e Teatrit “Çajupi” në datën 22 nëntor.

Monodrama “Velloja e bardhë” e autorit Odise Plaku, u interpretua në skenë nga aktorja Zamira Kita, e cila shfaqet ndryshe para spektatorit, me një profil dramatik.

Ngjarja e cila u përshkrua nga nota të dhimbshme kishte në qendër një grua, e cila prostituon e detyruar nga kushtet e vështira ekonomike. E gjithë ngjarja tregohet nga qelia e burgut, ku kjo grua është e detyruar të vuajë dënimin e saj. Shfaqja u vu në skenë nga regjizori Marko Bitraku me skenografi të Roland Karanxhës.

Shpallet Konkursi Mbarëkombëtar i Arteve Figurative “Vangjush Mio”

Qendra Kulturore në Korçë, çeli Konkursin Mbarëkombëtar të Arteve Figurative “Vangjush Mio”. Konkursi do të organizohet me mbështetjen e Bashkisë së qytetit nën kujdesin e veçantë të Kryebashkiakut Niko Peleshi. Në 10 vjet histori konkursi i filluar si një kompeticion mes artistëve lokalë, ka njohur rritje cilësore në drejtim të shtrirjes së hartës gjeografike të vendeve prej nga vijnë piktorët pjesëmarrës si edhe punëve cilësore të paraqitura prej tyre. Këtë vit konkursi do të jetë mbarëkombëtar, duke bërë të mundur vendosjen në plan kompetitiv të artistëve figurativë shqiptarë brenda dhe jashtë kufijve. Ekspozita me punët e përzgjedhura të piktorëve pjesëmarrës do të çelet në ambiente të Galerisë “Guri Madhi” në datën 20 dhjetor 2008, ditë në të cilën do të jepen edhe çmimet për artistët pjesëmarrës.



Bashkia e Korçës prezantohet në Panairin e Luganos

Në kuadrin e promovimit të qytetit si një destinacion turistik si dhe në zbatim të prioriteve të përcaktuara në Planin e Veprimit për Zhvillimin e Turizmit në Korçë, Bashkia e qytetit, mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit "I Viagjatori" në Lugano të Zvicrës.

Pjesëmarrja e Bashkisë në këtë Panair u mbështet edhe nga organizata hollandeze SNV.

Stenda e qytetit u vizitua nga pjesëmarrës dhe vizitorë të shumtë të panairit, të cilët treguan interes për Shqipërinë në përgjithësi dhe Korçën në veçanti.

Në panair u vendosën kontakte të rëndësishme për bashkëpunime të mëtejshme në fushën e turizmit.



Bashkia Korçë prezanton iniciativat e ndërmarrja për zhvillimin e turizmit në "Konferencën Ndërkombëtare të Turizmit"

Në Korçë, në datat 4 dhe 5 dhjetor u mbajt konferenca dyditore "Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm rajonal".

Konferenca pati si qëllim paraqitjen e programit "Zhvillimi dhe Menaxhimi i Destinacionit Turistik, rajoni Korçë", i cili mbështetet nga Fondacioni për Turizmin e Qëndrueshëm dhe Eliminimin e Varfërisë ST-EP në partneritet me Organizatën Botërore të Turizmit të Kombeve të Bashkuara UNWTO dhe Organizatën Hollandeze për Zhvillim SNV.

Në këtë konferencë u paraqitën rezultatet paraprake të studimit për zhvillimin e tregjeve dhe produkteve turistike për rajonin e Korçës, kryer nga dy konsulentë britanikë. Gjithashtu disa nga aktorët më të rëndësishëm që veprojnë në sektorin e turizmit si Ministria e Turizmit, GTZ, USAID, Universiteti Europian i Turizmit, Shoqata e Guidave Turistike, Shoqata Kombëtare e Turizmit, përfaqësues të pushtetit vendor etj shkëmbyen përvojat e tyre dhe diskutuan faktorët që ndikojnë në kthimin e një rajoni në destinacion turistik të suksesshëm.

Në këtë Konferencë, zv Kryetari i Bashkisë, Sotiraq Filo, njëkohësisht dhe Kryetar i Komitetit për Zhvillimin e Turizmit në Korçë, prezantoi iniciativat e ndërmarrja nga Bashkia e qytetit si dhe planet për të ardhmen në funksion të kthimit të Korçës në një qytet turistik.

Korça ku → dua të jetoj

Të jesh krenar për qytetin tënd!

Nëse jeni një i apasionuar pas fotografisë, kjo është mundësia jote. Dërgo foto të qytetit që të bën ty të ndihesh krenar për të.

Ne ju ftojmë të gjithëve të dërgoni foto nga ndërtesat, aktivitetet, festat apo çdo gjë tjetër që ju e keni përzemër, apo ju pëlqen ta shihni.

Çdo muaj, fotot më të mira do të publikohen në faqet e “Qyteti im” dhe në fund të vitit, ju do të keni mundësi të paraqisni punën tuaj në një ekspozitë enkas për ju, ku do të zgjidhet fotoja e vitit.

Kontakte:

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Bashkë me fotot dërgoni dhe një përshkrim të shkurtër të fotos dhe pse e keni zgjedhur pikërisht atë.

Korça në mbrëmje!

Fotoja e muajit: Panje nga qyteti
Autori: Pandush Sterjanaj



Mbledhja e Këshillit Bashkiak datë 27/11/2008

→ Rendi i ditës

1. Miratimi i ndihmës ekonomike për muajin nëntor 2008.
2. Për vendosjen në Qendrën Rezidenciale e emrit të qytetarit Myslym Kalem Abedini
3. Mbi ndryshimin e emërimit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore së Bashkisë Korçë.
4. Për miratimin e rregullores së brendshme bazë për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kopetencat e administratës së Bashkisë Korçë.
5. Për një shtesë fondi në inventarin e objektit “Sistemim në lagjet 1 dhe 2”.
6. Për ndryshim destinacioni fondi në shpenzimet operative.
7. Miratimi i bursave dhe gjysëmbursave të studimit për nxënësit e viteve të dyta e lart për vitin mësimor 2008-2009.
8. Miratimi i bursave dhe gjysëmbursave të studimit për nxënësit e viteve të para për vitin mësimor 2008-2009.
9. Miratim fondi për Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit.
10. Për një ndryshim në vendimin Nr.

102 date 31. 10.2008. “Për Fillimin e Procedurave për Zmadhimin të Kapitalit të Korça 2008 sh.a”.

11. Për ndryshimin e destinacionit të shpenzimeve operative të buxhetit të vitit 2008 të Klubit të Futbollit Korçë.

12. Mbi përcaktimin e kriterëve për dhënien e stimujve të nderit nga Këshilli I Bashkisë Korçë.

13. Miratim fondi prej 400.000 lekësh për ngritjen e Obeliskut “ABC” në kodrën ku u mbajt Mitingu i Shkronjave në vitin 1910.

14. Për miratimin e emërimit të shkollës së re, të ndërtuar në bllokun e ri të francezve, “Sotir Peci”, ose “Pandi Cici”.

Të nderuar qytetarë! Në rast se dëshironi të keni vendimet e plota të Këshillit Bashkiak, mund t'i merrni tek Zyra e Protokoll Arkivës, në Bashki, çdo ditë nga ora 12:00 – 14:00

Fjalën

e ke ti!

Komplimenta **Komente** **Ankesa**

Bashkia të ofron mundësinë të thuash atë që ti mendon mbi shërbimet e ofruara prej saj, sa pranë nevojave tuaja qëndrojnë ato dhe çfarë do të donit të bëhej më mire!

Ju mund të dërgoni **KOMPLIMENTE**, **KOMENTE** apo **ANKESA**

Ne kemi marrë përsipër t' ju sigurojmë shërbime sa më cilësore. Për këtë na duhet mendimi juaj. Nëse kemi bërë një punë të mirë apo jo, ne duam ta dëgjojmë këtë nga ju.

Fjalën e ke ti!

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Dorëzoni formatin e plotësuar pranë Zyrës së Informacionit "Bashkia Korçë"

Jepni sa më shumë informacion

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Të dhënat tuaja (jo e detyrueshme)

Emër Mbiemër:

Profesioni:

Adresa:

Tel:

e-mail:

Zgjidhni opsionin

- Komplimenta**
 Komente
 Ankesa



Kalendari Festiv i Panairit të Fundvitit

E enjte, 4 Dhjetor
Jashtë bashkisë
Në sheshin e panairit
Ora 19:00

E premte, 5 Dhjetor
Ekspozita e Kohëkronimeve
Qendra Kulturorë "V. Mio"
Ora 19:00

E shtete, 12 Dhjetor
Festivalet e Dhomave të Sportit (Kotumari dhe VIII Fajpo dhe Jilmeti Shqiptari)
Kina e Mëdhenë
Ora 19:00

E diel, 14 Dhjetor
Korri i Korës
Hulli i Kulturës "Rindëritja e Kujtimit"
Ora 19:00

17 dhe 24 Dhjetor
Teatri i Kulturës
Në sheshin e panairit
Ora 16:00

25-27 Dhjetor
"30 vjetorë për qytetin e Korçës"
Ekspozita e revistës "Qyteti Im"
Në sheshin e panairit

E diel, 21 Dhjetor
Korri i Korës
Në sheshin e panairit
Ora 19:00

E martë, 23 Dhjetor
Ekspozita e Krijësive dhe
Shfaqja e Teatrit "A.Z.Çajupi"
Hulli i Kulturës "Rindëritja e Kujtimit"
Koncert me Korë dhe Krijësive dhe
Shfaqja e Teatrit "A.Z.Çajupi"
Në sheshin e panairit
Ora 19:00

E enjte, 25 Dhjetor
Koncert i Korës "Pse Daj"
Hulli i Kulturës "Rindëritja e Kujtimit"
Ora 19:00

26, 27, 28 Dhjetor
Vartesa e Fundvitit me humor, këngë dhe surpriza
Teatri "A.Z.Çajupi"
Ora 18:00

30-31 Dhjetor
Koncerti i Korës (Kombëtar) / Artet e Figurave "V. Mio"
Qendra Kulturorë "V. Mio"
Ora 19:00

E enjte, 25 Dhjetor
Bashkimi me bashkëtimin e Fundvitit
Ora 19:00

E diel, 28 Dhjetor
Artet e vogël ju unjohin festat
Në sheshin e panairit
Ora 11:00

E diel, 28 Dhjetor
Ora Papardellë & The singles
Në sheshin e panairit
Ora 19:00

E martë, 31 Dhjetor
Ekspozita e Krijësive "Kërkimi dhe Gjetja"
Qendra Kulturorë "V. Mio"
Ora 19:00

Së fundmi 14 Dhjetor
"Bashkimi tregon përballë"
Ora 17:00

Përgatitën:

Ana Qeramixhi
Sofjola Kotelli
Mikel Llogori
Benila Tërova

Ndihmuan:

Stafi i Bashkisë Korçë
Pallati i Kulturës "V.Mio"
Ndërmarrja e Shërbimeve
Publike
Teatri "A.Z.Çajupi"

Fotot nga:

Ana Qeramixhi
Donald Braholli
Vaskë Niço
Ervis Bostanxhi

Design:

R&T Advertising

Për një qytet ku bashkëjetojnë tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje. Pas një kthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Mbështesni "Qyteti Im"



Për më tepër informacion:

Tel: 457-55

e-mail: bashkiko@almail.com

ëëë.bashkiakorçe.gov.al